



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

TERMA REFERENCE

Për Projektim objekti:
**“Ndërtim i njes Bërzhitë dhe rrugët lidhëse të autostradës Tiranë – Elbasan me
komunën Bërzhitë dhe zonat përreth ”**
(me çelësa në dorë)

TIRANË 2023

HYRJE

Autoriteti Rrugor Shqiptar me fondet e buxhetit të vitit 2023 ka planifikuar të financojë ndërtimin e objektit “Ndërtim i nyjes Bërzhitë dhe rrugët lidhëse të autostradës Tiranë – Elbasan me komunën Bërzhitë dhe zonat përreth”.

I. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM

Vendndodhja e hyrje-daljes në autostradën Tiranë – Elbasan propozohet të jetë pranë urës së Erzenit 1.6 km larg nga fshati Bërzhitë midis piketës 301 dhe piketës 357 të projektit të rrugës Tiranë – Elbasan.

Aktualisht lidhja e fshati Bërzhitë me qytetin e Tiranës, bëhet nëpërmjet Autostradës Tiranë–Elbasan.

Për drejtimin e lëvizjes Tiranë – Elbasan, banorët e fshatit Bërzhitë dhe zonat përreth, si dalje për në fshat dhe hyrje për në drejtimin e Elbasanit përdorin hyrje – daljen ekzistuese në zonën e biznesit të Palmanovës. Kjo rrugë lidhëse është e gjitha e asfaltuar.

Për drejtimin e lëvizjes Elbasan – Tiranë banorët e fshatit Bërzhitë dhe fshatrave përreth përdorin nyjen e Ibës dhe Mulletit që janë rreth 5 km larg nga njëra tjetra. Ky itinerar lëvizje kalon në rrugën e vjetër Tiranë – Elbasan.

Banorët e zonës së fshatit Qeha – Shytaj për daljen në autostradë përdorin rrugën që lidhet me nyjen e Mulletit.

Fshatin Qeha – Shytaj lidhet me fshatin Bërzhitë nëpërmjet urës ekzistuese të varur për këmbësorë, me një gjatësi rreth 140 m, duke shfrytëzuar nënkalimin ekzistues të ndërtuar gjatë ndërtimit të rrugës Tiranë – Elbasan.









III OBJEKTIVI

Objektivi kryesor është hartimi i një projekti të plotë zbatimi që të përmbushë kërkesat e Kushteve Teknike të Projektimit për Rrugët të vitit 2015, Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë dhe të akteve nënligjore që rrjedhin prej tij, Eurokodet etj
Objektivat specifikë janë:
Dhënia e një zgjidhje sa më të mirë me një kosto sa më ekonomike për këtë vepër.

IV QËLLIMI I PUNËS

Qëllimi i këtij projekti është krijimi i aksesit të banorëve të fshatrave Bërzhitë, Qeha – Shytaj në autostradën Tiranë – Elbasan.

Autoriteti Rrugor Shqiptar nisur nga problematikat e ngritura nga Bashkia Tiranë (Njësia Administrative Bërzhitë) dhe banorët e këtyre fshatrave, parashikon të ndërtojë një nyje për hyrje–dalje në autostradë dhe një rrugë dytësore për lidhjen e këtyre fshatrave me njëra – tjetrën. Kategoria e rrugës parashikohet të jetë F2 sipas Rregullit Teknik për Projektimin e Rrugëve të vitit 2015. Gjatësia e këtyre rrugëve, përfshirë rampat, parashikohet rreth 2.1km. Rruga e fshatit Qeha-Shytaj do të lidhet me rrugën e fshatit Bërzhitë nëpërmjet një ure të re automobilistike me hapësirë drite prej rreth 120ml.

Për hartimin e këtij projekti, kontraktori duhet të marrë në konsideratë:

- Zbatimin me përpikmëri të kërkesave të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, Rregullores për Zbatimin e Kodit Rrugor dhe akteve nënligjore.
- Zbatimin me përpikmëri të kërkesave të standarteve të projektimit në fuqi me rregullat e reja të projektimit dhe zbatimit të vitit 2015, Eurokodet etj

V. KËRKESAT PËR PROJEKT ZBATIMIN.

Në këtë fazë projektuesi do të hartojë projektin e zbatimit i cili përfshin përgatitjen e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kontraktori (konsulenti) për hartimin e projektit duhet të kontaktojë me pushtetin vendor dhe komunitetin të zonës për të marrë parasysh propozimet e tyre. Këto propozime do të përcillen paraprakisht pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe më tej do të vijohet me hartimin e projektit.

Konsulenti përgatit projektin përfundimtar, vizatimet e detajuara dhe preventivin përfundimtar. Projekti përfundimtar, specifikimet teknike, preventivi dhe vizatimet duhet të përfshijnë punime të plota civile, detaje arkitekturore, strukturore, mekanike dhe elektrike të projektimit dhe vizatime për të gjithë fazat e punimeve në detaje të mjaftueshme që ndërtimi të mund të kryhet pa qenë e nevojshme për modifikime të mëtejshme ose modifikime të vizatimeve. Projekti duhet të përfshijë specifikimet teknike të të gjithë materialeve që do të vendosen në vepër.

Raporti Përfundimtar i studimit Topografik

Raporti përfundimtar i Studimit Topografik duhet të përmbajë të gjithë informacionin e rëndësishëm topografik i cili nevojitet gjatë fazës së hartimit të projektit të zbatimit si dhe të asaj së zbatimit të punimeve. Varianti përfundimtar dhe i miratuar i zgjidhjes së planimetrisë i përcaktuar tashmë dhe i fiksuar në harta dixhitale duhet që për këtë fazë të fiksohet edhe në terren nëpërmjet pikave kryesore të rrjetit koordinativ, të cilat duhet të kenë koordinatat dhe kuotat përkatëse. Këto pika do t'i shërbejnë ndërtuesit për piketimin përfundimtar të aksit në terren, gjithashtu të fiksohen në terren piketat. Sistemi koordinativ i hartimit të hartave topografike do të jetë sistemi shtetëror i miratuar.

Në këtë fazë Konsulenti do të paraqesë një raport të saktë të vendodhjes së piketave kryesore të vendosura prej tij për zbatimin e punimeve.

Raport i veçant topografik do të përgatitet për veprat e mëdha të artit (urat).

Të gjitha kuotat e rrugës do të jenë absolute dhe të fiksuara në repera fikse betoni.

Në çdo rast me fillimin e punimeve nga kontraktori fitues, konsulenti do të jetë prezent për dorëzimin e këtyre piketave.

Raporti përfundimtar i Studimit Gjeologjik dhe Gjeoteknik.

Studimi gjeologjik duhet të jetë i saktësuar duke përfshirë të gjithë dukurinë, aksin, këndin dhe analizën e saktë gjeomorfologjike të zonave ku shtrihet ky objekt.

Raporti i Studimit Gjeologjik duhet të përpilohet për secilën dukuri fiziko-gjeologjike duke përfshirë dhe materialet e ndërtimit.

Raporti i Studimit Gjeologjik do të ketë përmbajtjen si më poshtë:

- Fotografi ilustrative të kësaj zone.



- Harta gjeologjike e zonës, material grafik, planimetri, prerje gjeologo-inxhinierike.
- Përcaktimi i vetive fiziko-mekanike të nevojshme për llogaritjen e zgjidhjes përfundimtare të ndërtimit të kësaj vepre.

Raporti përfundimtar i Studimit Hidrologjik.

Studimi hidrologjik duhet të jetë i saktësuar duke përfshirë të gjithë dukuritë, pellgun ujëmbledhës të Erzenit apo dhe të prurjeve tjera e përgjatë aksit rrugor.

Raporti duhet të përmbajë:

- Tekstin e raportit, llogaritjet hidrologjike dhe zonat ujëmbledhëse.
- Materialin grafik
- Hartat
- Planimetritë
- Konkluzionet e rekomandimet e grupit që ka përgatitur studimin.

Raporti përfundimtar i llogaritjeve statike dhe dinamike

Në këtë fazë konsulenti duhet të paraqesë raportin përfundimtar të llogaritjes statike dhe dinamike për veprat e artit si ura, tombino, mure mbajtës, mure pritës etj. Raporti duhet të jetë i detajuar dhe duhet të përmbajë:

Standartin e përdorur për llogaritjet mbi të cilat është hartuar projekti i tyre, ngarkesat, modelimin, rezultatet dhe interpretimin i rezultateve. Raporti duhet të jetë i firmosur nga projektuesi.

Përgatitja e metodologjisë përfundimtare të punimeve të ndërtimit

Metodologjia e ndërtimit ndërmjet të tjerave duhet ti referohet dhe çështjeve mjedisore, të cilave duhet t'i kushtojë vëmendje kontraktori (konsulenti).

Këtu kontraktori (konsulenti) do të japë dhe propozimin e tij për vendet e marrjes materialeve që do shërbejnë për realizimin e zbatimit të këtij objekti. Në këtë fazë gjithashtu, kontraktori (konsulenti) do të përshkruajë nëse është e nevojshme dhe punimet ndihmëse, nevojat e spostimeve të masave për devijimin e pjesshëm të trafikut apo tjera që dalin gjatë ndërtimit të veprës.

Kontraktori (konsulenti) do të përshkruajë në mënyrë të veçantë dhe masat e marra për sigurinë rrugore përfshirë dhe sinjalistikën.

Konsulenti (kontraktori) do të përshkruaj në mënyrë të veçantë dhe masat e marra për menaxhimin e trafikut, aplikimin e skemave të përkohshme, sigurinë rrugore përfshirë dhe sinjalistikën, horizontale dhe vertikale.

Nyja për hyrje daljet të jetë e ndriçuar.

Raporti përfundimtar i shpronësimeve

Konsulenti në këtë fazë do të përshkruajë në mënyrë të qartë dhe të hollësishme listën e pronarëve që shpronësohen, sipërfaqet e tyre, llogaritjet e sipërfaqeve si dhe vlerën e plotë të shpronësimit. Konkretisht në këtë fazë konsulenti duhet të paraqesë:



1. Planimetri Shpronësimi (në formatin A3) mbi harta kadastrale e vulosur nga projektuesi, në të cilën të jenë të dhënat e pronës që shpronësohet si më poshtë:
 - a. Emër, Atësi, Mbiemër
 - b. Numër pasurie, zonë kadastrale, sipërfaqe shpronësimi
 - c. Të jenë të rëluara objektet dhe të përcaktohen me ngjyrë të kuqe objektet që preken nga realizimi projektit.
 2. Planimetri shpronësimi (në formatin A3) mbi fotografimin ajror të vitit 2015, në të cilën të jenë të dhënat e pronës që shpronësohen si më poshtë:
 - a. Emër, Atësi, Mbiemër
 - b. Numër pasurie, zonë kadastrale, sipërfaqe shpronësimi
 - c. Të jenë të rëluara objektet dhe të përcaktohen me ngjyrë të kuqe objektet që preken nga realizimi projektit.
- Për pikat 1 dhe 2, duhet që të jetë një vijë shpronësimi e mbyllur (poligon i mbyllur), në të cilin të jenë të konturuara me hatch të lehtë të gjitha sipërfaqet që shpronësohen.
3. Planimetri shpronësimi (në formatim DWG, sistemi koordinativ UTM) mbi hartat kadastrale.
 4. Planimetri shpronësimi (në formatim DWG, sistemi koordinativ UTM), mbi fotografimin ajror të vitit 2015
 5. Lista e pasurive që shpronësohen, e cila duhet të përmbajë:
 - a. Emër, Atësi, Mbiemër
 - b. Numër Pasurie
 - c. Zonë Kadastrale
 - d. Sipërfaqe totale e pasurisë
 - e. Sipërfaqe shpronësimi
 - f. Lloji i pasurisë
 6. Kartelat dhe hartat për të gjitha pasuritë që preken (të jenë brenda afatit 1 muhor)
 - a. Kartelat dhe hartat duhet të kenë vulën lidhëse të institucionit (A.SH.K përkatëse)
 - b. Kartelat duhet të kenë faqen e pasme (Seksioni d dhe e)
 - c. Në rast se një kartelë rezulton e mbyllur duhet të ketë kartelën vijuese.

Volumet e punës dhe Preventivi

Bazuar në llogaritjet dhe vizatimet e projektit kontraktori (konsulenti) do të hartojë një listë me të gjitha zërat e punimeve që janë pjesë përbërëse e listës përfundimtare të volumeve (Preventivi), bazuar në Manualin Teknik të Çmimeve të punimeve të Ndërtimit të vitit 2015.

Preventivi do të shoqërohet me tabelat e volumeve dhe mënyrën e llogaritjes së tyre. Projektuesi/kontraktori duhet të paraqesë bashkëngjitur preventivit një përmbledhëse me të dhënat tekniko-ekonomike të projektit ku të përfshihen, por pa u kufizuar: Kategoria e rrugës, Gjatësia, Gjerësia, Pozicioni gjeografik dhe vlera ndërtimore e objektit. Të tjera sipas natyrës dhe llojit të ndërhyrjes në infrastrukturën rrugore.

Përgatitja e Raportit Përfundimtar Teknik të Projektit të Zbatimit.

Raporti i projektit të zbatimit do të përfshijë të gjithë informacionin e mësipërm si dhe të reflektojë në trajtë të shkruar arsyet mbi të cilat është bazuar hartimi i detajuar i projektit.



Për vetë specifikën e këtij projekti Drafti i raportit përfundimtar të projektit të zbatimit do të të paraqitet në formë zyrtare tek A.Rr.Sh-^{ja} për shqyrtim dhe miratim.

Vizatimet

Kontraktori (konsulenti) në fazën e projektit të zbatimit në formë grafike duhet të hartojë vizatimet e mëposhtme duke organizuar pjesën bazë të dokumentave të kontratës për zbatimin e punimeve.

1. Planimetri të gjendjes ekzistuese
 2. Detaje teknike të projekt zbatimit në shkallë 1:25, 1:50
 3. Profila tërthor tip SH 1:25; 1:50.
 4. Duhet të shoqërojë materialin me foto dhe video të bëra gjatë inspektimeve për hartimin e projektit.
- Plani i menaxhimit të trafikut gjatë zbatimit të punimeve të zbatimit referuar skemave përkatëse sipas manualit të sinjalizimit rrugor.
 - Planimetri e sinjalistikës dhe detajet.

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

Objekti: “ Ndërtim i nyjes Bërzhitë dhe rrugët lidhëse të autostradës Tiranë – Elbasan me komunën Bërzhitë dhe zonat përreth, me çelësa në dorë” i nënshtrohet procedurës së vlerësimit paraprak të VNM-së, hartimi i Raportit të VNM-së dhe Relacionit Teknik duhet të bazohet në: Vendimin Nr. 686, datë 29.7.2015 ‘Për Miratimin e Rregullave, të Përgjegjësisë e të Afateve për Zhvillimin e Proçedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe proçedurës së Transferimit të Vendimit të Deklaratës Mjedisore’”.

PËR FAZËN E PROJEKT-ZBATIMIT konsulenti do të dorëzojë:

- 1. Raportin paraprak të VNM-së**
- 2. Relacionin Teknik të projektit të propozuar**

1. Në Raportin paraprak të VNM-së, duhet të përfshihen:

- a) përshkrimi i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar dhe me fotografi;
- b) informacion për praninë e burimeve ujore, në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij;
- c) informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme, negative, në mjedis, të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër;
- ç) një përshkrim për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve; *(Duhet të identifikohen venddepozitimet për mbetjet e ngurta të autorizuara nga pushteti vendor.)*
- d) informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuar;



dh) të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të;

e) mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin;

ë) masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;

f) ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë).

2. Në Relacioni Teknik të projektit të propozuar, duhet të përfshihen:

a) qëllimin e projektit të propozuar;

b) planimetrinë e vendndodhjes së projektit, ku të pasqyrohen në hartë topografike kufijtë e sipërfaqes, të shoqëruar me koordinatat sipas sistemit shtetëror të miratuar, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti, gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë;

c) informacionin për qendrat e banuara, në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën e tyre nga vendndodhja e projektit të propozuar, si dhe përcaktimin e njësisë së qeverisjes vendore që administron territorin ku propozohet projekti;

ç) skicat dhe planimetritë e objekteve dhe strukturave të projektin, si dhe mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve dhe strukturave të projektit;

d) përshkrimin e proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese /përpunuese, sasi të lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit;

dh) informacionin për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacionin për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja;

e) programin për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar për funksionimin e projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes, pas mbarimit të funksionimit të projektit;

ë) lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyra e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji);

f) informacionin për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit;

g) informacionin për alternativat e marra në konsideratë, për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret;

gj) të dhënat për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasi të ujit të nevojshëm, të energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre;

h) aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.;

i) informacionin për lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/ licencimin e projektit;



j) kopje të lejeve, autorizimeve dhe licencave që disponon zhvilluesi për projektin e propozuar, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/licencimin e projektit.

Për fazën e ndërtimit kontraktori duhet të pajiset me lejet si më poshtë:

Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm dhe aplikimi për marrjen e VENDIM PËR VNM PARAPRAKE, bazuar në ligjin Nr. 10440, datë 07.07.2011'' PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS'' (VNM-së) të ndryshuar, dhe VKM nr. 686, datë 29.07.2015 ''Për miratimin e rregullave, të përgjegjësi e të afateve për zhvillimin e procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore'' për objektin që do të ndërtohet.

- Përgatitja e dokumentacionit për heqjen nga fondi pyjor në mbështetje të VKM nr.1353, datë 10.10.2008 ''Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe të kriterëve e të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes e të vëllimit të fondit pyjor'', i ndryshuar, si dhe të VKM nr.1374, datë 10.10.2008 ''Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor'',
- Përcaktimi i venddepozitim të interteve nga Njësi e Vetëqeverisjes Vendore(NJVV)
- Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për aplikimin e Lejes së Infrastrukturës bazuar në ligjin Nr. 107/2014 datë 31.07.2014 ''Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit'' i ndryshuar dhe në Vendimin Nr. 408, datë 13.05.2015.
- Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për kërkesën: ''Për përdorim të burimeve ujore për veprimtarinë ndërtimore në brigje'', bazuar në ligjin nr. 111/2012, datë 15.11.2012 ''Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore'' si dhe VKM nr. 416, datë 13.05.2015 ''Për miratimin e kushteve të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatin e vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit dhe vendimmarrjes, si dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore''.

KËRKESAT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT

Bazë për fazën e ndërtimit të objektit :

''Ndërtim i nyjes Bërzhitë dhe rrugët lidhëse të autostradës Tiranë – Elbasan me komunën Bërzhitë dhe zonat përreth''

do të shërbejë Rregulli Teknik për Ndërtimin e Rrugëve (RrTNRr), 2015.

Për fazën e ndërtimit kontraktori (konsulenti) duhet të pajiset me lejet si më poshtë:

- Përcaktimi i venddepozitim të inerteve nga Njësi e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV).
- Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për aplikimin e Lejes së Infrastrukturës bazuar në ligjin Nr. 107/2014 datë 31.07.2014 ''Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit'' i ndryshuar dhe në Vendimin Nr. 408, datë 13.05.2015.

FAZAT, AFATET DHE MIRATIMET

Fazat

Fazat e parashikuara dhe afatet orientuese për ndërtimin e objektit janë:



Projekti

Projekti i zbatimit për nyjen dhe rrugët dytësore	2 muaj nga data e lidhjes së kontratës
Oponenca teknike	1 muaj
Miratimi në ARRSH	15 ditë

Organizimi i Kantjerit

Ndërtimi i kantjerit	10 ditë
Ndërtimi sipas projektit	12 muaj
Monitorimi dhe garancia e difekteve	24 muaj

Të gjitha fazat do të kontrollohen dhe miratohen nga ARRSH.

Kontraktori në fund të çdo faze duhet të paraqesë këto raporte :

Raportet e projektimit (të detajuar sipas proceseve)

Raport të detajuar të ecurisë së punimeve.

Raportin teknik (të detajuar sipas proceseve, topografik , gjeologjik , gjeoteknik, hidrologjik etj)

Raportin e menaxhimi të trafikut dhe sinjalistikës provizore gjatë kryerjes së punimeve.

Raportin e monitorimit gjatë ndërtimit.

Afatet

Kontraktori (Konsulent) duhet të përcaktojë me detaje sipas fazave të parashikuara afatet kohore të realizimit të punimeve. Afatet e dhëna në tabelën më sipër janë vetëm orientuese. Afatet do të jenë funksion i metodologjisë së ndërtimi dhe organizimit të brendshëm të kontraktorit (konsulentit). Në çdo rast afatet e dhëna nga kontraktori (konsulent) duhet të jenë të arsyetuara dhe të shoqëruara me shpjegimet e përdorimit, ciklit të punës së makinerive, fuqisë punëtore.

